

GJYKATËS THEMELORE TË PRISHTINËS
DEPARTAMENTIT PËR ÇËSHTJE EKONOMIKE
lidhur me rastin **EK.nr. 316/20**

Paditëse: **Federata Sindikale e Pavarur e PTK-së («Sindikata»)**
përfaqësuar nga juristët Getoar Mjeku dhe Blerim Sallahu

i paditur: **DARDAFON.net L.L.C. («Z Mobile»)**

e interesuar: **Telekomi i Kosovës, SH.A. («Telekomi»)**

E hënë, 10 gusht 2020

PARASHITRESË E PADITËSE-PROPOZUESËS

1. Paditëse-propozuesja Sindikata saktëson kërkesën për masa të sigurimit, të parashtruar me padinë e 17 korrikut 2020,¹ dhe propozon prova shtesë në mbështetje të kërkesës.
2. Në përputhje me nenin 297 LPK, Sindikata ka dëshmuar besueshmërinë e padisë dhe rrezikun e dëmit të pariparueshëm.

Besueshmëria e padisë

3. Padia është e besueshme. Ka bazë ligjore: sipas neni 95 LMD, pala e interesuar mund të kërkojë vërtetimin e nulitetit të kontratës që cenon rendin publik, dispozitat urdhëruese ose moralin e shoqërisë. Ka objekt të qartë: Marrëveshja Telekomi–Z Mobile. Dhe ka pretendime të mbështetura: Marrëveshja është nule sepse jep shërbime të pakufizuara pa detyrim për të mbuluar koston, shkel dispozitat ligjore duke lejuar ndëshkime të shumëfishta, si dhe rrezikon ndërmarrjet publike, industrinë e telekomunikimeve dhe sigurinë shtetërore.

Dëmi i pariparueshëm

4. Sindikata po kërkon masa sigurimi për të parandaluar tri rreziqe:
 - (1) dëmi i ri nga kërkesat e Z Mobiles;
 - (2) tjetërsimi i pasurive të Z Mobiles; dhe
 - (3) falimentimi i Telekomit dhe cenimi i sigurisë shtetërore.

1 Shih pjesën VII, para. 187–213.

Dëmi i ri

5. Telekomit dhe punëtorët rrezikohen nga këto kërkesa të Z Mobiles:
 - (1) përbarimi i borxhit prej 25 milionë eurosh, sipas vendimit të arbitrazhit që rrjedh nga Marrëveshja;
 - (2) vazhdimi i Marrëveshjes ose një kontratë e re të ngjashme; dhe
 - (3) dëmshpërblim prej dhjetëra miliona eurosh për shkëputjen e Marrëveshjes, mosvazhdimin e saj ose moslidhjen e një kontrate të ngjashme.
6. Si provë mbështetëse, propozojmë parashtresën e Z Mobiles, drejtuar përbaruesit privat, për zhblokimin e llogarive, për shkak se aksionari dhe bordi i drejtorëve i Telekomit kanë premtuar negociata për të gjetur një zgjidhje. Një zgjidhje e këtillë do të nënkuptonte detyrime të reja për Telekomin.

Provë: Rasti P.nr. 491/2019 (PPP.nr. 1486/2019) Parashtresë e kreditorit për lirim e përkohshëm të llogarive bankare të debitorit, drejtuar përbaruesit privat Ilir Mulhaxha, 29.7.2020, nr.prot. 301/20

Tjetërsimi i pasurisë së Z Mobiles

7. Z Mobile nuk ka klientë nga nëntori 2019. Prandaj, ka rrezik që Z Mobile të tjetërsojë pasuritë ose që aksionarët të tërheqin kapitalin e tyre, duke pamundësuar realizimin e kërkesëpadisë. Njëri nga aksionarët ka shtetësi të huaj, dhe Kushtetuta lejon tërheqjen e kapitalit jashtë vendit.²
8. Si provë mbështetëse, propozojmë vendimin e rregullatorit ARKEP që i bart të gjithë numrat e Z Mobiles te operatori amë.

Provë: ARKEP, Vendim nr. 1455 për Caktimin e Numeracionit Jo-Gjeografik (mobil) nga seritë (0)45 5xx xxx, (0)45 6xx xxx dhe (0)46 1xx xxx për përdorim nga Operatori Telekomit i Kosovës Sh. A., 15.10.2019

2 Kushtetuta, neni 119.6.

Falimentimi dhe siguria shtetërore

9. Z Mobile tashmë ka zbrazur llogaritë rrjedhëse të Telekomit, duke sjellë ndërmarrjen buzë falimentimit. Çdo detyrim shtesë ndaj ndërmarrjes mund të shkaktojë falimentimin. Bashkë me Telekomin do të binte edhe ndërmarrja tjetër publike «Posta e Kosovës» ShA, veprimtaria dhe të hyrat e së cilës lidhen ngushtë me Telekomin. Sindikata përfaqëson bashkë rreth 3.500 punëtorët e Telekomit dhe të Postës.
10. Falimentimi i Telekomit do të rrëronte krejt industrinë e telekomunikacionit në Republikën e Kosovës. Telekom, veçanërisht përmes brendit të vet «Vala», mbizotëron shërbimet e telefonisë mobile, duke numëruar gati 1 milion klientë. Operatorët e tjerë kanë kapacitete dukshëm më të vogla, dhe nuk do të mund t'u bënin ballë kërkesave të menjëhershme. Kurse mbështetja e klientëve përmes infrastrukturës së Telekomit do të kërkonte ndërmarrje solvente dhe të aftë për të përballuar shpenzimet e mbështetjes dhe për të bërë investime të mëtejme në infrastrukturë.
11. Falimentimi në fund **cenon rëndë sigurinë shtetërore**. Telekom është operatori i vetëm që ofron disa shërbime kyçe për institucionet e Republikës së Kosovës. Telekom është pronar i rrjetit ekzistues të fibrave optikë, mundëson komunikim përmes këtij rrjeti pa kaluar nëpër server të operatorit, dhe ofron i vetmi shërbimin Centrex të telefonisë fikse me numrat 200. (Kurse rregullatori nuk lejon bartjen e numrave nga një operator te tjetri.)

Provë: Agjencia e Shoqërisë së Informacionit, Shkresë ministrit të Punëve të Brendshme dhe të Administratës Publike, rreth shërbimeve telekomunikuese të Telekomit të Kosovës, ref. 041/20, nr.prot. 462, 9.3.2020
12. Me rënien e Telekomit, bie rrjeti që shërben institucionet qendrore e lokale, Kuvendin, presidencën, Qeverinë, Policinë, Forcën e Sigurisë, Agjencinë e Inteligjencës, gjykatat, prokurorinë, si dhe institucionet e pavarura.
13. Kështu rrezikohen — në kohë pandemie — institucionet shëndetësore. Preken edhe institucionet arsimore, që mësimin po e zhvillojnë në largësi, përmes internetit. Dhe në fund, kanoset mbarëvajtja e gjyqësorit, në një kohë kur ka filluar implementimi i sistemit SMIL dhe

mbajtja e seancave përmes telekonferencave. Gjykatat rrezikohen njëjloj me rënien e Postës së Kosovës, që është e lidhur ngushtë me Telekomin.

14. Ngjashëm, rrezikohen organizata të tjera vendore e ndërkombëtare, që marrin shërbime nga Telekom i Kosovës.

Provë: Listë e kontratave të rëndësishme të Telekomit të Kosovës, me institucionet shtetërore, ndërmarrje të mëdha dhe bankat, si dhe përfaqësitë, bizneset dhe organizatat e huaja e ndërkombëtare, korrik 2020

15. Për këto arsye, lutim Gjykatën e nderuar të caktojë masa sigurimi për të ruajtur rrethanat e tanishme dhe për të parandaluar dëmet e mëtejme ndaj Telekomit dhe shtetit të Kosovës.

Përmbyllje

16. Njëherësh, lutim Gjykatën e nderuar të konstatojë edhe gjendjen e rëndë financiare të Sindikatës si propozuese dhe që masat t'i caktojë pa kërkuar garanci, në përputhje me nenin 297.3 LPK.³
17. Në përfundim, duke u thirrur në nenin 306.1 LPK, paditëse-propozuesja i rithekson Gjykatës kërkesën për këtë:⁴

AKTVENDIM

- I. **Miratohet** si e themeltë kërkesa e paditëse-propozueses Federata Sindikale e Pavarur e PTK-së për masa të sigurimit ndaj të paditur-kundërpropozuesit DARDAFON.net L.L.C.
- II. **I ndalohe**t të paditur-kundërpropozuesit:
- (A) të vazhdojë Marrëveshjen e mbështetjes e operatorit të rrjetit mobil virtual, lidhur me ndërmarrjen publike Telekom i Kosovës, SH.A., më 16 janar 2009, dhe përfunduar më 30 korrik 2019;
- (B) të negociojnë për të lidhur kontratë tjetër për rrjet virtual të telefonisë mobile; dhe

3 Shih dhe parashtrësën fillestare, 17.7.2020, para. 205.

4 Përsëritur nga parashtrësja fillestare, para. 213.

- (C) të zbatojnë çfarëdo kontrate që mund të kenë lidhur gjatë kohës mes përpilimit të kërkesës së paditës-propozueses dhe shqyrtimit të saj.
- III. **I ndalohet** të paditur-kundërpropozuesit DARDAFON.net L.L.C. të tjetërsojë, të fshehë, të ngarkojë ose të disponojë me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme me vlerë deri në 264.000.000,00 euro.
- IV. **I ndalohet** të paditur-kundërpropozuesit DARDAFON.net L.L.C. që në cilësinë e kreditorit të kërkojë ose të pranojë nga ndërmarrja publike Telekom i Kosovës, SH.A., ose nga aksionari i saj:
- (A) përmbushjen e detyrimeve nga Vendimi final i arbitrazhit i 9 dhjetorit 2016, nxjerrë për rastin 20990/MHM pranë tribunalit të Odës Ekonomike Ndërkombëtare (ICC); dhe
- (B) përmbushjen e detyrimeve të tjera që mund të caktohen sipas Marrëveshjes së mbështetjes e operatorit të rrjetit mobil virtual, lidhur me ndërmarrjen publike Telekom i Kosovës, SH.A., më 16 janar 2009.
- V. **Detyrohet** i paditur-kundërpropozuesi të pezullojë të gjitha veprimet që ka nisur në kundërshtim me këtë aktvendim.
- VI. Ky aktvendim mbetet në fuqi deri në një vendim të ri të Gjykatës.

Me respekt,

Dr. Getoar Mjeku, jur.
përfaqësues i paditëses

Rr. Enver Maloku, nr. 15
10000 Prishtinë
+383 45 30 52 00
gm@getoar.com